

Duke u bazuar në nenin 108/A par. 3.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, lidhur me nenin 4 të Rregullave për parashtrim të ankesave -FO3, OE "SKY GROUP SGS" shpk" lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV DHE SANIMI I GJENDJES NGA VERSHIMET.633-023-012-111**, brenda afatit ligjor parashtron këtë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM

Një ankesë kundër: **KOMUNA E ISTOGUT**

(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)

Për Aktivitetin e Prokurimit: **Nr. i prokurimit 633-23-2733-1-1-1**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Nr i brendshëm: 633-023-012-111

Sa i përket tenderit me titull: **RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV DHE SANIMI I GJENDJES NGA VERSHIMET.633-023-012-111**.

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Grupi i OE: **"SKY GROUP SGS" shpk**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Ulpiana Rr.Bul.Dëshmorët,H.II,kati I nr5,.

(Adresa)

Prishtinë, Kosovë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

(Numri Telefonit)(Numri i Faks-it) **049 500 080**

03.05.2023 sgsgroup.shpk@gmail.com

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës e parashtro ankesën vetëm

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë"apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi



për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi për Kontratë në KRPP me dt. 27.03.2023
- Lloji i procedurës së aplikuar Procedurë e Hapur
- Lloji i kontratës – furnizim
- Vlera e kontratës: 350,000.00 euro
- Vlerë e madhe:
- Kriteri për dhënien e kontratës: tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët;
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave përmes platformë elektronike 08.05.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☐

Kërkesa për Rishqyrtim parashtrohet në fazën para tenderuese

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☐

Kërkesa për Rishqyrtim parashtrohet në fazën para tenderuese



6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues – KOMUNA E ISTOGUT me ndryshimin e kërkesave lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional lidhur me kërkesën nr 2 duke shtuar kërkesa diskriminuese ka vepruar në shkelje të rënda të **Ligjit të Prokurimit Publik 04/L-042 të konsoliduar**, pikërisht të të parimeve bazike të prokurimit dhe dispozitave si në vijim:

- Neni 1 par 1, 2 dhe 2 (Qëllimi) i LPP-së lidhur me parimet bazike nga neni 4.4 i RrUOPP;
- Neni 7 par.1, 2 dhe 4 (Barazia në trajtim/Jo-diskriminimi)
- Neni 28 të LPP-së lidhur me nenin 20 të RrUOPP;

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datën 27.03.2023, AK – Komuna e Istogut përmes platformës e- prokurimi e ka publikuar dosjen e tenderit dhe materialin tjetër tenderik lidhur me aktivitetin e prokurimit **“RIPARIMI I RRUGEVE LOKALE TE RENDIT IV DHE SANIMI I GJENDJES NGA VERSHIMET.633-023-012-111.**

Në përmbajtjen e kërkesës lidhur me mundësitë teknike dhe profesionale tek kërkesa Nr. 2 sa i përket mjetet stabilimentet dhe paisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit është kërkuar që **Operatori ekonomik duhet të ketë Kërkesa 2 -**

- Dhjetë (10) Kamion veteshkarkues (kipper) me kapacitet min.10m3.
- Dy (2) Ngarkues kapacitet min.3m3. , - Nje (1) Ngarkues me peshe prej 6-7 ton , - Nje (1) Grejder min 10ton. - , -Nje (1) Grejder min 16 ton. - Nje (1) Buldozer min 15ton.
- Nje (1) Eskavator me rrota, me peshe 5-7 ton , - Dy (2) Cilindra min.12 tona vibrues
- Dy(2) eskavator me zinxhir me peshe min 30 tona



Pretendimi Nr. 1

Elementi që paraqet diskriminim, kufizime të panevojshme me të cilën kufizohet konkurrenca e drejtë dhe e ligjshme për pjesëmarrjen sa më të gjerë të OE të intresuar është për faktin të hiqet pjesa e kërkesës Nr:2 ose të ndryshohet sipas argumenteve me posht: 1.1"Nje (1) Grejder min 16 ton. , 1.2- Dhjetë (10) Kamion veteshkarkues (kipper) me kapacitet min.10m3, - 1.3Dy (2) Ngarkues kapacitet min.3m3, - 1.4Nje (1) Ngarkues me peshe prej 6-7 ton , - 1.5Nje (1) Eskavator me rrota, me peshe 5-7 ton ,

Andaj te pretendimi Nr 1, kryesisht pika 1.1 të largohet grejderi min 16t ose të zëvendësohet me grejder min 13 t (1 copë), pasi që në këtë projekt një grejder i tillë nuk nevojitet, pra një kerkese e tillë nënkupton favorizimin ndaj ndonjë OE të posaqem që ka një makineri të tillë dhe specifikisht grejder 16t, pra grejderi mundet të jetë nga 10t deri në 20t, sepse nuk ka lidhje qfar tonazhe ka grejderi ne kete projekt mirpo puna qe do e kryje.

Tek pretendimi Nr 1, kryesisht pika 1.2 Dhjetë (10) Kamion veteshkarkues (kipper) me kapacitet min.10 m3, një kërkesë e tillë duhet të ndryshohet pasi që 10 Kamion të kërkuar në këtë projekt është një kërkesë e cila eliminon menjëherë OE të tjerë nga pamundësia për të kompletuar 10 Kamion dhe me sakt min 10 m3, një kërkesë e tillë favorizon OE të caktuar , pasi që për këtë projekt 3 vjeçarë nuk nevojiten 10 Kamion, dhe ne qoft se edhe ndonje OE ka 5 kamion mund të kryej punë të njëjtë vetem ta rritë planin dinamik dhe të ofroj plan dinamik me te detajuar të furnizimit ku mund të përmbush kapacitetin e kërkuar nga AK për sasin e kërkuar gjatë javës, muajëve, dhe vitit, dhe që të mos nënkontrakttoj apo të marrë makineri me qira ku OE mund të dëmtohet për pagesa mbi qira, andaj që konkurrenca të jetë më e lirë dhe më transparente të ndryshohet kjo kërkesë, andaj kerkesa 1.2 të zëvendësohet me Pesë (5) Kamion (kipper) min 10 cm3

Tek pretendimi Nr 1, kryesisht pika 1.3 dhe 1.4 , Dy (2) Ngarkues kapacitet min.3m3, Ngarkues me peshe prej 6-7 ton , një kërkesë e tillë duhet të ndryshohet pasi që 3 ngarkues të kërkuar në këtë projekt është një kërkesë e tepruar dhe se një kërkesë e tillë favorizon OE e caktuar që ka makineri të tilla dhe që punët tjera në këtë projekt mund të kryhen edhe nga Eskavatorët me zinxhir pesh min 30 poashtu edhe nga Eskavatori me rrota dhe se për këtë projekt nuk nevojiten 3 ngarkues , një kërkesë e tillë dhe eliminon OE të tjerë, andaj kërkesa sipas pretendimit 1, pika 1.3 dhe 1.4 të zëvendësohet me Një (1) Ngarkues 5t deri 20 t.

Në këtë kuptim ndryshimi i kërkesës paraprake me përzgjedhjen e elemente të natyrës diskriminuese/kufizuese krijon dyshime rreth se kërkesa i përshtatet OE të caktuar me qëllim për të kufizuar konkurrencën në raport me OE tjereë ekonomik.

Është e habitshme se si në aktivitetin e njëjtë të prokurimit me lëndë dhe objekt të njëjtë, bëhen ndryshime/përzgjedhen kërkesa të ndryshme njëra me tjetrën të cilat favorizojnë ose diskriminojnë një apo më shumë operatorë ekonomik. sipas dëshirës të kërkesave.

Prandaj, për këto arsye, kërkojmë që kërkesa në fjalë të ndryshohen dhe zavendësohen e cila është relevante/proporcionale me lëndën dhe objektin e kontratës dhe që nuk paraqet kërkesë diskriminuese e cila kufizon konkurrencën dhe pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik dhe në anën tjetër nuk favorizon një apo më shumë operatorë ekonomik të caktuar.



Pretendimi Nr. 2

Në përmbajtjen e kërkesës minimale për objektet përcjellëse, të gjitha kërkesat nga 2.1 deri në 2.9, janë kërkesa që janë të hartuara në atë formë që favorizojnë OE të caktuar. Disa nga kërkesat në mënyrën siç janë vendosur përbëjnë ndërhyrje tek e drejta e OE-së, tejkalojnë kufijtë e autorizuar me ligj, pasi nuk është në kompetencën e AK-së për vendosjen dhe përcaktimi se si të duken, çfarë hapësire duhet të përbajnë objektet përcjellëse të OE. Kjo kërkesë nuk mund të ketë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në eliminimin e konkurrencës, mirëpo kërkesa e tillë duhet të përshtatet kushteve relevante të qëllimit të prokurimit dhe të gjejë zbatim pas dhënies së kontratës dhe para nënshkrimit të kontratës.

Prandaj, për këto arsye, kërkojmë që kjo kërkesë të modifikohet deri në masën që nuk ndërhyr në kushtet e afarizmit të OE, dhe të zavendësohet duke e korrigjuar në pjesë të caktuara me një kërkesë relevante që nuk e ka efektin e qëllimin e krijimit të pengesave, dhe si e tillë të gjejë aplikim sipas propozimit të bërë më lartë.

Kërkesat e lartshënuara si të tilla bien ndesh me kërkesat ligjore të LPP-së nga dispozita e neni 1 paragrafi 1 dhe 2, neni 7 par. 1 dhe 2 si dhe neni 28 lidhur me neni 20 të RRUOPP, pasi që janë diskriminuese dhe shkelin parimin e barabarsisë të parimeve bazike të prokurimit publik sipas neni 4.4 të RRUOPP.

Andaj duke u bazuar në argumentet dhe provat e paraqitura më lartë, kërkojmë nga AK-Ministria e Infstrakturës, të ndërmerr masat e nevojshme për të heq nga dosja e tenderit kërkesat diskriminuese që bien ndesh me dispozitat e lartshënuara të LPP-së dhe RRUOPP, me propozim të marrë vendim në atë mënyrë që të **PRANOHET** e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim e OE ankues konform propozimeve të bëra.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura